PORTRETI VETJAK TE LIRIKA E NAIM FRASHËRIT DHE AJO E JOSIF BAGERIT

THE AUTHORIAL SELF-PORTRAIT IN THE LYRIC POETRY OF NAIM FRASHERI AND JOSIF BAGERI

Esmije VESELI, Adelina XHAFERI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
esmije.veseli@unite.edu.mk & adelina.xhaferi@unite.edu.mk

Abstrakti

Letërsia shqipe ka një brumë mjaft të veçantë letrar, një brumë në të cilin përditë e më shumë gjenden elemente të një përditshmërie të mbarë shoqërisë, apo edhe të një individi të vetëm, si pjesë e kësaj të fundit. Prandaj, me anë të kësaj kumtese, ashtu siç paraqitet që në titull do të shihet se si autorët shqiptarë, përfaqësues të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Naim Frashëri dhe Josif Bageri e paraqesin portretin vetjak te lirikat e tyre të ashtuquajtura "*Fjalët e qiririt*" dhe "*Prej vetit kënk-mbaronjës*". Duke qenë se lirikat e tyre qenë dikur dhe mbeten edhe në të sotmen një dëshmi e hollë, e gjallë dhe mjaft e nevojshme e rrjedhës së letërsisë shqipe në secilën periudhë të saj, si dhe duke qenë se brumosen për ta dhënë një të vërtetë të kohës së djeshme edhe në një të sotme të pasosur dhe të padjegur, duhet përmendur që, pos gjithë elementeve të tjera karakterizuese, pra elementeve letrare, krijimet e tyre paraqiten edhe nëpërmjet gdhendjes së portretit vetjak brenda vargjeve lirike. Ky portret vetjak që zë vend të dukshëm në lirikat e tyre dhe vjen në të sotmen me secilin varg të tyre të shpërthyer nga thellësia e shpirtit, lehtas dhe pa droje për një dritë të vazhdueshme që i duhej shoqërisë së kohës (dhe jo vetëm) do të shihet në këtë kumtesë nëpërmjet metodës së deduksionit dhe nëpërmjet metodës së analizës letrare.

Fjalët çelës: Naimi, Bageri, letërsia, lirika, portreti vetjak

Abstract

Albanian literature possesses a distinctly unique literary substance, a foundation in which, increasingly, elements of the everyday life of society as a whole are found, as well as those of a single individual as part of it. Therefore, through this presentation, as indicated in the title itself, it will be examined how Albanian authors-representatives of the period of the Albanian National Renaissance-Naim Frasheri and Josif Bageri portray the self-portrait in their so-called lyrical works: "*The words of the Candle*" ("*Fjalët e Qiririt*") and "*From Myself, as a Lyric Crafter*" ("*Prej vetit kënk-mbarojnës*"). Considering that their lyric poetry, both in the past and in the present, remains a delicate, living, and highly necessary testimony to the development of Albanian literature in each of its periods, and given that it is shaped to convey a truth of the past that persists into an uninterrupted and enduring present, it should be noted that, alongside all other characteristic elements-namely literary features-their works also present the shaping of the self-portrait within lyrical verses. This self-portrait, which occupies a prominent place in their lyric poetry and reaches the present through each of their lines, expressed with ease and without hesitation from the depths of the soul as a continuous light needed by the society of the time (and not only), will be examined in this presentation through the method of deduction and literary analysis.

Key words: Naim, Bager, literature, lyric poetry, authorial self portrait

1. Hyrja

"Rilindja Kombëtare Shqiptare me të gjitha aspektet dhe dimensionet e saj të ndryshme (historike, shoqërore, politike, ekonomike, kulturore, arsimore, ideologjike, ideoestetike dhe filozofike) është njëra nga epokat më të pasura të trashëgimisë historike dhe shpirtërore të kombit shqiptar." [1] Me natyrën e saj ajo arriti që ta linte gjurmën më të madhe në letërsinë shqipe sepse i dha figurat më të rëndësishme që e krijuan këtë letërsi dhe që shumë më vonë e hapën rrugën edhe për krijuesit e periudhave tjera. Ndaj, që në fillim të këtij punim duhet pohuar se, fryma e shkrimtarëve shqiptarë të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare është

[1] Masar Stavileci, (1990), Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Rilindja, Prishtinë, f. 93.

njëra ndër frymët më të veçanta me të cilat karakterizohet letërsia shqipe si tërësi e vetes. Në brendinë e saj, nga njëra kohë në tjetrën, nga njëri autor te tjetri një vend mjaft të veçantë dhe të dukshëm për nga njohja e tërësishme e letërsisë shqipe zë edhe paraqitja e elementit vetjak, një element ky i bartur në artin e letërsisë që nga kohët më të vjetra të krijimit të saj, që nga kohët kur arti për qenien njerëzore nuk ishte vetëm art, por edhe një dëshmi e gjallë e një përditshmërie/jetese në të cilën frymonin jetët e shqiptarëve. Andaj, me njohjen e të gjitha periudhave të saj letrare, me njohjen e të gjithë autorëve shihet qartë se çfarë është menduar e çfarë është punuar për të mirën e këtij populli, duke u nisur nga vetja.
Duke qenë se shkrimtarët e periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare tashmë e kishin mësuar se nëpërmjet gjuhës së tyre amtare mund të dilte një varg i ëmbël, i gjerë, i lehtë, i lirë, i bukur dhe me vlerë, ata e panë se kjo gjuhë "edhe në vepër tregohej e zonja, meqë mund të shprehte bukuri dhe gjendje të ndryshme shpirtërore dhe natyrore, koncepcione e mendime shkencore, filozofike, etike, shoqërore, si dhe ndjenja të thella patriotike në mënyrë të pa bërë ndonjëherë më parë." [2] Prandaj, një vëmendje mjaft të madhe morën edhe krijimet e dy poetëve: Naim Frashërit dhe Josif Bagerit, të cilët duke e paraqitur portretin vetjak, u munduan që ta paraqisnin të vërtetën e popullit shqiptar dhe të ndihmonin që ky popull ta merrte rrugën e drejtë nëpërmjet dijes dhe kapërcimit të vetes. Me poezitë e tyre të titulluara si: "*Fjalët e qiririt*" dhe "*Prej vetit kënk-mbaronjës*" këta dy poetë u munduan që ta vinin veten në vendin e qiririt dhe duke krijuar për shqiptarët poezi të bukura te të cilat gjendeshin figurat më të bukura dhe më të gjetura të kohës, ta ndihmonin në mënyrën më të mirë përparimin e përgjithshëm shqiptar dhe veten e tyre ta vinin në rendin e shembujve të drejtë, siç është vetë vetja e Naimit dhe vetë vetja e Josifit.

2. Rezultatet dhe diskutimet

Portreti vetjak te lirika e Naim Frashërit *"Fjalët e qiririt"*

"*Naim Frashëri është figura qendrore e letërsisë shqiptare të Rilindjes. Ai u bë shprehës i aspiratave të popullit për liri e përparim*." [3] Si i tillë, ai është zëri kryesor dhe përfaqësues i krijimtarisë letrare të krijuar dhe të brumosur në periudhën e romantizmit shqiptar, gjegjësisht në periudhën e të ashtuquajturës Rilindje Kombëtare Shqiptare, një periudhë kjo në të cilën ai e "*njohu më mirë jetën e popullit, zakonet, virtytet dhe aspiratat e tij, gjuhën e bukur e shpirtin poetik të njerëzve të thjeshtë, krijimtarinë popullore, bukurinë e natyrës shqiptare*" [4] dhe shumë elemente të tjera, me të cilat ngjizet dhe ndërtohet në tërësinë e saj krijimtaria e tij lirike. Kjo krijimtari e tij e gdhendur me një frymë të veçantë dhe mjaft të bukur arriti që t'i bënte ballë secilës kohë dhe me të plotën e saj ta paraqiste anën më të mirë, si në shpërthimin e subjekteve të ndryshme lirike (vetes dhe tjetrit), ashtu edhe në përshkrimin e jashtëm të shumë elementeve që zënë vend dhe bëhen pjesë e botës së madhe të letërsisë shqipe. "*Prej pasurisë ideore dhe tematike të veprave, prej procedimeve sipas të cilave sendërtohen ato ide dhe tema, prej larmisë gjinore, llojore dhe nënllojore të krijimeve, prej mundësisë që të merret me fushat e ndryshme të krijimtarisë artistike dhe diturore, prej njohurive të gjera letrare, filozofike dhe shkencore, që dëshmohen në veprat e fushave të ndryshme krijuese - prej të gjitha këtyre shihet qartë se Naim Frashëri është krijues me dhunti të shumëllojshme dhe me kërshëri të gjera në letërsinë shqipe të romantizmit."* [5]
Nga të gjitha gjërat të cilat mund të thuhen për krijimtarinë letrare të Naim Frashërit si rilindës (apo si zë i romantizmit shqiptar), pra nga të gjitha karakteristikat (elementet/tiparet) me të cilat

[2] Po aty, f. 216.
[3] Naim Frashëri, (2010), Bagëti e Bujqësia, Lulet e verës, Vjersha të tjera, reklama, Tiranë, f. 3.
[4] Po aty, f. 3/4.
[5] Rexhep Qosja, (1990), Porosia e madhe, Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, Rilindja, Prishtinë, f. 17.

ndërtohet bota e tij letrare (artistike), duhet thënë se "*veçoritë e stilit të krijimtarisë së një shkrimtari gjithmonë kushtëzohen prej përmbajtjeve të trajtuara në veprat e tij dhe prej qëndrimit emocional ndaj tyre. Zgjedhja e përmbajtjeve në masë të madhe kushtëzohet prej botëpërjetimit dhe prej botëkuptimit të tij, në përgjithësi. Ashtu edhe veçoritë e stilit të krijimtarisë së Naim Frashërit, para së gjithash, kushtëzohen prej përmbajtjeve të trajtuara në veprat e tij. Zgjedhjen e përmbajtjeve të veprave të tij, ndërkaq, në masë të madhe e kushtëzojnë synimet historike kombëtare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*".[6]

"*Mbi çdo shkrimtar të kohës së vet, Naimi u bë përfaqësuesi më i plotë i idealeve të Rilindjes. Sadoqë letërsia artistike në gjuhën shqipe kishte njohur edhe vepra të shquara, siç qenë të De Radës, askush përpara Naimit nuk pasqyroi me aq gjerësi dhe nuk iu përgjigj aq flakë për flakë e drejtpërdrejt kërkesave të lëvizjes së çlirimit kombëtar. Me veprimtarinë e dendur letrare dhe me punën si një ndër udhëheqësit kryesorë të lëvizjes, ai, me të drejtë, është cilësuar frymëzues i gjithë Rilindjes*".[7] [sic!] Në këtë mënyrë, "*në lirikën e tij është përfaqësuar njeriu i asaj kohe me një kompleksitet ndjenjash e mendimesh, me vrulle të papërmbajtura patriotike dhe ndonjëherë me rënie shpirtërore për jetën personale, i etur për dituri e përparim dhe i trazuar nga ndjenja e paragjykime mistike, me dashuri të sinqertë e të pastër për njerinë dhe me shpresë se do të arrihet mirëkuptimi dhe harmonia shoqërore, i dhënë në dashuri, por i paçliruara prej patetikës platonike, adhurues i natyrës e i fshatarit, himnizues i trimërisë e i atdhedashurisë. Të gjitha këto, siç është vënë re, janë përcaktuar prej kushteve historike të periudhës së rëndësishme kur jetoi poeti dhe janë pasojë e ndikimeve të ndryshme, nganjëherë edhe të kundërta filozofike*".[8] [sic!]

I nisur për ta vënë veten e tij në mesin e njerëzve të tjerë, si dhe për ta shprehur këtë gjë në mesin e vargjeve të ndryshme lirike, duhet pohuar se "nëpërmjet kësaj poezie lirike, në formë alegorike, Naim Frashëri e ka formuluar kredon e vet poetike dhe ka shfaqur disa mendime të përgjithshme, mbi poetin dhe poezinë. Në këtë lirikë, me çiltërsinë e madhe që e karakterizon vargun e tij lirik, ai e ka zbuluar shpirtin dhe qëllimin e poetit romantik, patriot dhe humanist me zemër të madhe, i gatshëm të bëhet fli për idealet e veta" [9] (e jo vetëm), si me këto vargje:

"Në mes tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj ditë.
Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,
Njëri-tjatërin të njihni."[10]

Prania e tij në mesin e njerëzve të tjerë të kohës (dhe jo vetëm), me të cilët e ndante një kohë të përbashkët, ashtu si edhe një sistem sundues, poeti, duke e vënë veten e tij në qendër të gjithçkaje kërkonte që të pranohej si i njëjtë dhe mbi të gjitha gjërat (veprimet) e bëra prej tij të ndriçohej jeta e përbashkët, për të cilën mundoheshin mendjet më të ndritura të periudhës në të cilën jetonte dhe vepronte vetë Naim Frashëri. Do të thotë, gjatë leximit dhe studimit të kësaj lirike naimiane, shihet se dëshira për dituri, dëshira për ndriçim të mendjes së njeriut të kohës (dhe jo vetëm) dhe të bërit mirë për tjetrin (qoftë ai afër, apo larg vetes së poetit në fjalë), nga ana (fryma) individuale, kapërcen tek ana (fryma) kolektive, si me këto fjalë:

"Unë jam në shpirtin tuaj,
Mos më kini për të huaj,

[6] Po aty, f. 273.
[7] Grup autorësh, (1989), Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, f. 175.
[8] Po aty, f. 193.
[9] Po aty, f. 231.
[10] Naim Frashëri, (2010), Bagëti e Bujqësia, Lulet e verës, Vjersha të tjera, reklama, Tiranë, f. 106.

M'është falurë durimi,
Andaj po digjem si trimi,
Se ma k'ënda t'u bënj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë."[11]

I bindur që nëpërmjet fjalës së bukur dhe ndihmës së dhënë për njerëzit e popullit të djegur, ky poet i Rilindjes Kombëtare do ta bënte më të mirën dhe tërë dashurinë e madhe të cilën do ta kishte në shpirt, do ta derdhte për të tjerët, me ç'rast, pas sosjes së qëllimit, përvëlimit dhe djegies së vetes do të nisej te perëndia, si me vargjet e thëna me fjalët e mëposhtme:

"Në shpirt kam dashurinë,
Pa digjem për njerëzinë,
Lemëni të përvëlohem,
nukë dua më të ftohem,
Dua ta djek trupn' e shkretë
Për atë zotn' e vërtetë.
Me zjarr ta djek mushkërinë
E të tretem për njerinë,
Bashkë me gëzimt të tija
të vete te perëndia."[12]

Vargjet e Naim Frashërit të cilat e vënë në qendër të gjithçkaje vetë subjektin lirik, pos gjithë pikave të tjera të cilat e zbukurojnë dhe e vënë në pah flijimin e vetvetes për ndriçimin e të tjerëve, me fjalët të cilat do të shihen më poshtë, shihet se poeti (liriku) dëshiron që t'ua bëjë me dije të tjerëve se ai, si subjekt i gjallë dhe i vërtetë lirik nuk i shihte vetëm ata të kohës së sotme, pra ata te të cilët i niste vargjet lirike, por se i kishte njohur edhe të parët e tyre, të cilët pos si fis e farë, kishin qenë edhe miq të vjetër në një vend të përbashkët. Pra, ndonëse në këtë poezi me shkrirje të dukshme dhe të zëshme të qiririt (prapa të cilit fshihet jeta e poetit) mëtohet për t'u dhënë e vërteta e portretit vetjak, shihet se shpesh kalohet edhe te kolektivja:

"Unë duke përvëluar,
Njerëzit i kam ndrituar.
Kam qënë mik me njerinë,
Andaj i di e më dinë.
Gjithë tuajt' i kam parë,
Mëm' e at' e fis e farë,
Si tani gjithë i kam ndër mënt,
Që rrininë më këtë vënt."[13]

Me një gjuhë të zjarrtë, rreth së cilës i gjente fjalët më të bukura dhe më të dëlira, ky subjekt lirik duke e dhënë në qendër të krijimit të tij portretin vetjak e paraqet kapërcimin e vetes për ta ndihmuar tjetrit, të cilin e shihte me sy tjetër dhe shumë ndryshe nga sytë e kohës, ndaj për ta herë flinte në baltë, herë ndodhej në mjaltë, herë ishte kec e herë ishte lule, si në vargjet:

"Shumë herë fle në baltë,
Diku ndodhem dhe në mjaltë
Bënem qëngj e kec i pirë,
Lul' e bar e gjeth i mbirë.
Dua shumë fjalë t'u them,
Po trëmbem mos i bënj ujem.
E ku shkruhenë në kartë
Fjalët' e gjuhësë zjarrtë?"[14]

[11] Naim Frashëri, (2010), Bagëti e Bujqësia, Lulet e verës, Vjersha të tjera, reklama, Tiranë, f. 106/107.
[12] Po aty, f. 107.
[13] Naim Frashëri, (2010), Bagëti e Bujqësia, Lulet e verës, Vjersha të tjera, reklama, Tiranë, f. 107/108.
[14] Po aty, f. 108.

Portreti vetjak te lirika e Josif Bagerit "*Prej vetit kënk-mbaronjës*"

*(Kjo poezi e Bagerit është botuar në gazetën "**Shpnesa e Shqypnis**", në numrin e saj të tretë, më 1 shkurt të vitit 1907 në Dubrovnik të Republikës së Kroacisë)*

Në periudhën e ashtuquajtur Rilindje Kombëtare Shqiptare, një zë mjaft i njohur e i dëgjuar, që vjen edhe në të sotmen me një krijimtari mjaft të veçantë letrare është ai i Josif Bagerit. Ky shkrimtar, i ardhur brenda letërsisë nga Reka e Epërme e Gostivarit arriti që ta krijonte një varg mjaft të bukur dhe të veçantë për letërsinë shqipe dhe ashtu si poeti i parë më sipër në rrjedhë të këtij punimi, ta sillte edhe portretin vetjak. Portreti vetjak i këtij poeti, ashtu siç del në të gjitha vargjet e mëposhtme, sillet rreth veprimeve të veta, të cilat i niste për t'u bërë mirë të tjerëve, për t'ua ndriçuar jetën dhe rrugën e tyre duke e mësuar gjuhën e të parëve, pavarësisht hapësirës në të cilën e kishte degdisur jeta e tij, me ç'rast shihet se edhe në këtë poezi, poeti lidhet drejt një qëllimi: shkrirjes së vetes për diturinë e të tjerëve, si me vargjet:

"Mjaft kujtova se s'kom msime;
Mjaft përtova në këtjet!
Detyr kom gjuhën e ime:
Kënk të shkruej e kom gjet.
Kënk u ndreqa ta këndoni:
Burra, gra, djem e cuca –
Dhe u lutem mos përtoni,
Po gjuhën e vet ju mësoni!"[15]

I vendosur në një vend tjetër dhe larg frymës së atdheut të tij, ky poet (subjekt lirik) e krijon vargun e tij duke e lënë anash edhe moshën e rënduar, këmbën dhe dorën që i dridhej, vetëm që pena e tij të mos ndalej, ta çonte deri në fund qëllimin e jetës së tij dhe në të nesërmen e përbashkët m'u kjo ngjyrë e pendës së tij ta sillte ndryshimin e njeriut, si me këto vargje:

"Mjaft më dridhën këmb e duer,
Mjaft kujtova se s'di gjë!...
Kështu sot mendja ma muer –
Pendën pi dore mos lo..."[16]

Në vargje të tjera të kësaj poezie, në të cilat portreti vetjak del i dukshëm që në fillim të vargjeve të para, poeti pohon që dikur kishte shëtitur në kullota të ndryshme me dhentë dhe dhitë e tij me një fyell në duar, ndërsa sot, që toka e Shqipërisë (rreth së cilës gjithnjë e më shumë i niste vargjet e tij) së tij të përparonte dhe të shndriste si yjet në qiell, duhej që në dorë, në vend të fyellit ta kishte lapsin dhe në mendje një punë të vazhdueshme, si me fjalët:

"Mjaft me fyll kam vishllue,
Mjaft kullota dhen e dhii;
Tani lypën me punue –
Për me shëndrit këtShqypni".[17]

I bindur që koha si bari kishte mbaruar dhe toka e tij dhe e të parëve të tij kishte nevojë për gjëra më të mëdha e më të bukura, ky poet lirik pohon se, ndryshe nga e djeshmja kur rrinte ndër hije dhe shëtiste si bari, sot thurte këngë për djemtë e rinj, pra për njerëzit e popullit të tij. Ky zgjim i popullit do të ndihmonte në ruajtjen e vetes, ngase siç e pohojnë edhe vargjet e mëposhtme, armiqtë e tokës së Shqipërisë ishin në anë të ndryshme. Ja si e thotë poeti këtë:

"Mjaft kom flet uni nan hie,
Mjaft kom kon njëher barii;
Tani dhe mu short më bie,

[15] Josif Bageri, (1995), Reka, vendi im, Bashkësia Kulturore Shqiptare, Tetovë, f. 107.
[16] Po aty.
[17] Josif Bageri, (1995), Reka, vendi im, Bashkësia Kulturore Shqiptare, Tetovë, f. 107.

Kënk me dreq për djem të rii".[18]
"Mjaft vishlleva me kafallin,
Mjaft e bajta këtë janxhik;
Me pend lypën t'sqoj Shqyptarin,
Se ka m'dy-tri an anmik".[19]

I nisur për ta sosur veten e tij, si dhe për ta ndriçuar jetën e popullit të tij që përditë e më shumë nisej për të marrë rrugë të huaja dhe lihej jashtë truallit të të parëve, ky poet i periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare qe i bindur që në të sotmen e tij (e sotmja e secilës kohë), tokës së Shqipërisë i duheshin njerëz punëtorë, njerëz që e dinin gjuhën e tyre, njerëz që e ruanin kujtimin e vjetër, që e ndihmonin të mirën e përbashkët dhe mbi të gjitha njerëz që ishin të bashkuar për ruajtje të vetvetes, si me fjalët e thëna në strofën më poshtë:

"Mjaft ndëgjova un bjegrime,
Mjaft më lagu shi e dbor,
Tani m'kan ardhun kujtime:
Për Shqypnin t'quhen punëtor".[20]

Në këtë poezi, në të cilën në secilin varg duket elementi baritor dhe kapërcimi i vetes së poetit për ta zënë kohën e re dhe për ta ndryshuar të ardhmen e vetes dhe popullit të tij, shihet se në mënyrën më të bukur letrare lihet koha e vjetër dhe zihet koha e re. Kjo e fundit, ashtu siç del nga vetë poezia duhej të vinte e bardhë dhe me dritë si për individin, ashtu edhe për kolektivin e tij, sepse tokës së Shqipërisë i duhej drita e të gjithëve dhe të gjithë lidheshin drejt një qëllimi të tillë. Prandaj, në vargjet e mëposhtme, poeti del pa përtesë dhe i lumtur që me dorën e tij e shkruante gjënë më të bukurën për tokën e tij, si me fjalët e mëposhtme:

"Mjaft me shqerra un u gzova,
Mjaft dhe bylmete kom ngron;
Qindro Shqypni, se s'përtova...
Për Ty shkrujë e lumja amë!..."[21]

Në strofën e fundit të kësaj poezie në të cilën poeti Josif Bageri e paraqet veprimin e vetes, pra në qendër të poezisë e vë portretin vetjak, duket thirrja e tij që koha e vjetër të lihet anash dhe të mos përsëriten veprimet e djeshme, ashtu si këtë subjekt lirik, edhe të tjerët i nxiste që ta merrnin librin dhe të arrinin të bëhesh poetë, si me këto vargje të fundit të kësaj poezie:

"Majft ma n'livadhe u shtrina,
Mjaft në bjeshk edhe në fush;
Gjuhën e vet t'shkruj e mbrrina:
Libra me kënk jom tuj mbush.
Mjaft kom kjon kpuc-mbaronjës,
Mjaft punova këtë mjeshtri;
Tani due me kjon shkronjës -
Me sa t'di, Vjershor të mbrri".[22]

3. Konkluzionet

Nga të gjitha fjalët e pohuara më sipër, si dhe nga të gjitha vargjet e dhëna në këtë punim shkencor, del që periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare i ka nxjerrë figurat më të mëdha dhe më të dalluara për popullin shqiptar, ngase të tillët, nuk e kanë bërë më të mirën vetëm për veten e tyre, por për një popull të tërë që duhej të ndriçonte dhe të përparonte në secilin hap të kohës që vinte. Prandaj, në mesin e tyre u dallua si pena e shkrimtarit Naim Frashëri, ashtu

[18] Po aty.
[19] Po aty, f. 108.
[20] Josif Bageri, (1995), Reka, vendi im, Bashkësia Kulturore Shqiptare, Tetovë, f. 108.
[21] Po aty.
[22] Po aty.

edhe pena e shkrimtarit Josif Bageri, të cilët në krijimet e tyre e paraqitën si elementin romantik, ashtu edhe elementin me natyrë edukuese, në një kohë kur tokës së Shqipërisë i duheshin më shumë se sa poetë, pra ndriçues të mendjes njerëzore dhe ndihmues të çlirimit të brendisë së popullit shqiptar. Ndaj, "*figura qendrore e romantizmit shqiptar është njëherësh edhe njëra ndër figurat qendrore të prirjes iluministe të tij për njohjen e mendjes si forcë themelore të njohjes dhe të përvetësimit të botës; për njohjen e arsyes si mjet vlerësimi të çdo vepre dhe të bëre; për bindjen se njeriu si individ dhe populli si kolektiv kanë nevojë të gjykojnë në mbështetje të arsyes në mënyrë të pavarur; për besimin se njeriu mund të përsosej moralisht; për nevojën e zhvillimit dhe të përparimit të arsimit në përgjithësi, të atij në gjuhën kombëtare në veçanti, si kusht i zhvillimit shoqëror; për luftën që i kishte shpallur obskurantizmit fetar dhe shkencor dhe ngjyrave të tyre; për kujdesin dhe bindjen e edukimit humanist të njeriut; për nevojën e emancipimit të gruas në familje dhe në shoqëri; për luftën kundër zakoneve prapanike; për nevojën e këmbimit ndërkombëtar të ideve, të mendimit, të veprave diturore dhe artistike; për besimin se arti mund të sjellë ndryshime pozitive në jetën shoqërore; dhe, më në fund, për nevojën e respektit të ndërsjellë të pavarësisë, të gjuhës dhe të kulturës së çdo populli, të jetesës së përbashkët dhe në harmoni të popujve, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, fetare dhe krahinore*".[23]

Prej veprës së shkruar nga pena e Naim Frashërit "*mund të shihet qartë se Naim Frashëri është një figurë e gjithanshme dhe gjithanshëm e rëndësishme në letërsinë, në kulturën dhe, në përgjithësi, në historinë e popullit shqiptar. Ai është vjershëtor, por ai është edhe mendimtar, dijetar, pedagog dhe mësues i popullit. Kërshëria e gjithanshme mendore do ta bëjë të gjerë dhe të gjithanshme edhe veprën e tij, në të cilën spikasin shikimet e përpikta të dijetarit, shikimet e gjera të mendimtarit dhe shikimet e thelluara imagjinare të vjershëtorit - të krijuesit racionalist, që botën e njeh me mendje dhe të romantikut, që për botën kallëzon emocionalisht. Dhuntia e gjithanshme i ka bërë të mundshme që letërsisë, kulturës dhe, në përgjithësi, jetës shpirtërore të popullit të vet t'ia sjellë ato që i kanë munguar, ato që më së shumti iu kanë dashur në një periudhë aq të rëndësishme sikundër ishte ajo e Rilindjes Kombëtare dhe ato që, mandej, do t'i duhen në periudhat e mëvonshme. Me ato që ka sjellë, por që kanë munguar, ai ka arritur ta çojë përpara jetën arsimore, kulturore, letrare, morale, në tërësi, jetën shpirtërore të popullit shqiptar*."[24] Të gjitha këto e shtojnë vlerën e veprës së tij letrare dhe bëjnë që secila faqe e shkruar prej tij të marrë ngjyrime të reja dhe ta zë secilën kohë të re, pa e lënë anash as edhe shembullin e drejtë dhe të mirë të cilin e sillte për të gjitha ata që vendosën ta ndiqnin rrugën e tij, siç qe edhe vetë Josif Bageri. Ky i fundit qe vetë zëri i ri i shembullit të Naimit, zëri i ri i punës së bardhë, zëri i ri i thurjes së lirikës me dritë dhe dashuri, zëri i ri i një toke shqiptare që duhej ndryshuar përditë e më shumë. Prandaj, në këtë punim shkencor u panë krijimet letrare të të dy poetëve në fjalë, të cilët duke e vënë në qendër të krijimit të tyre portretin vetjak, e ndezën fenerin e mbarë popullit shqiptar për dije, çlirim dhe përqafim të gjësë së drejtë dhe të ndritur.

Referencat

[1] Abazi. N. 2009. Poezia didaktike e Josif Bagerit. Ylberi plus. Tetovë.
[2] Bageri. J. 1995. Reka, vendi im. Bashkësia Kulturore Shqiptare. Tetovë.
[3] Baliu. B. 2014. Struktura e vlerave përfaqësuese. OLYMP. Prishtinë.
[4] Frashëri. N. 2010. Bagëti e Bujqësia. Lulet e verës. Vjersha të tjera. reklama. Tiranë.
[5] Grup autorësh. 1989. Historia e letërsisë shqiptare. Rilindja. Prishtinë.
[6] Qosja. R. 2000. Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi II. Botimet TOENA. Tiranë.
[7] Qosja. R. 1990. Porosia e madhe. Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit. Rilindja. Prishtinë.
[8] Stavileci. M. 1990. Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Rilindja. Prishtinë.

[23] Masar Stavileci, (1990), Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Rilindja, Prishtinë, f. 223.
[24] Rexhep Qosja, (1990), Porosia e madhe, Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, Rilindja, Prishtinë, f. 557/558.